



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.1; 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronjat b) s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, dispozitave përkatëse të nenit 11, dhe nenin 16 të Ligjit 04/L-174 për planifikim hapësinor, neneve 14, 15 paragrafët 1 dhe 2.4; nenin 19 paragrafët 1.2 dhe 1.19 të Statutit të komunës së Podujevës nr.prot 01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 korrik 2021, mori këtë;

V E N D I M

Neni 1

Me këtë Vendim autorizohet dhe obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si autoritet përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, që të përgatitë plotësim ndryshimet e dokumentit të projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028, dhe të vazhdoj me procedurat tjera ligjore, në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe në koordinim të plotë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

Neni 2

Arsyeja e autorizimit sipas nenit 1 të këtij vendimi, është se gjatë shqyrtimit të Projekt Hartës Zonale 2020-2028 të Komunës së Podujevës, me qëllim që t'i jepet një zgjidhje variantit aktual, Kuvendi i Komunës nuk e mbështeti, përkatësisht votoi kundër që dokumenti në fjalë të miratohet si i tillë, por që i njëjti të ndryshohet dhe plotësohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit duke zhvilluar të gjitha procedurat në përputhje me legjislacionin e planifikimit hapësinor, në mënyrë që dokumenti final i Hartës Zonale të Komunës së Podujevës, ndër të tjera, të jetë sa më i aplikueshëm, që ankesat e qytetarëve të merren parasysh, që bizneseve t'iu krijohet hapësirë më e madhe për zhvillim, që ndarja e blloqeve brenda zonës urbane të jetë pa dallime dhe në kushte të barabarta, si dhe bujqësisë t'i jepet prioritet në zhvillim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtoritë e Komunës, varësisht fushveprimtarisë së tyre

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-350/05-0063175/21
Podujevë, 30 korrik 2021

